

Prishtinë: 10/04/2005

Kodi i ZRrE-së: D_02_2005

Zyra e Rregullatorit të Energjisë

Duke marrë parasyshë:

1. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/9 “Për Rregullatorin e Energjisë”;
2. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/10 “ Për Energji Elektrike”;
3. Politikat e dorëzuara nga Korporata Energjetike e Kosovës (“KEK”) tek Zyra e Rregullatorit të Energjisë (“ZRrE”) në Nëntor 2004;
4. Komentet në politikat e ofruara nga ZRrE-ja dhe takimet me ESBI/KEK të mbajtura me 6 Janar, dhe respektivisht 25 Shkurt 2005;
5. Letrat e KEK-ut të datës 8 Shkurt dhe 8 Mars 2005;

Ka vendosur të:

- a) Aprovoj kërkesën e KEK-ut në lidhje me Procedurën për shkyçje ashtu siç është përfshirë në Kapitullin 1 të këtij vendimi.
- b) Aprovoj kërkesën e KEK-ut në lidhje me Programin e Pagesave dhe Gjjobave ashtu siç është përcaktuar në Kapitullin 2 të këtij Vendimi.

Kapitulli 1: Procedura e Shkyçjes

1. Dispozitat e Njoftimit për Shkyçje

KEK-u i lëshon konsumatorit njoftimin për shkyçje para shkyçjes bazuar në:

- a) mospagesën e një fature të energjisë elektrike ose një pjese të një fature të energjisë elektrike;
- b) konunsumin e paautorizuar, vjedhjen e energjisë, ngacmimin ose konsumim tjetër të paautorizuar të energjisë;
- c) ngacmimin ose dëmtimin e rrjetit ose paisjeve, ose për qëllime të operimit ose mirëmbajtjes, nëse kërkohet;
- d) braktisjen ose kur kyçja nuk është më në përdorim; ose
- e) refuzimin për të lejuar të hyjë një përfaqësues i KEK-ut në pronën e konsumatorit për qëllim të leximit të matësit ose për inspektim.

2. Arsyet kur një njoftim për shkyçje nuk lëshohet nga KEK-u

Një njoftim për shkyçje nuk kërkohet si në rrethanat në vazhdim, kur:

- a) rrezikohet siguria ose shëndeti i personave; ose
- b) shkyçja bëhet me kërkesë të konsumatorit.

3. Periudha e njoftimit për shkyçje

Një njoftim për shkyçje duhet t'i dërgohet konsumatorit me shkrim së paku dhjetë (10) ditë të punës para datës së deklaruar në njoftim për shkyçje.

4. Përmbajtja e Njoftimit për Shkyçje

Një njoftim për shkyçje të konsumatorit duhet të përfshijë:

- a) emrin e konsumatorit dhe numrin serik të pikës matëse;
- b) arsyen dhe bazën ligjore për shkyçje;
- c) adresën dhe informatën për kontakt të zyrës ku konsumatori mund të marrë më shumë informata dhe/ose demonstroj që masat e kërkuara, nëse ka ndonjë, janë ndërmarrur;
- d) datën kur është caktuar të bëhet shkyçja;
- e) kushtet dhe procedurat të cilat konsumatori duhet t'i përmbush me qëllim që të kërkoj rikyçje;
- f) procedurat për parashtrimin e ankesës kundër ndërmarrjes së energjisë me qëllim që të mënjanohet ndërprerja e kontestit, dhe kohën dhe procesin për përgjigje në një ankesë të tillë.

5. Metoda e dërgimit dhe marrjes së njoftimit

KEK-u do të dërgoj njoftimin me shkrim sipas mënyrës në vazhdim:

- a) dërgoj me postë konsumatorit në adresën e treguar në të dhënat e ndërmarrjes së energjisë; ose
- b) dërgoj personalisht tek konsumatori ose antari i banimit të tij ose saj në adresën e treguar në të dhënat e KEK-ut.

6. Kontesti dhe hulumtimi para shkyçjes

6.1. KEK-u nuk duhet të shkyç një konsumator i cili informon KEK-un që ai ose ajo konteston arsyet për shkyçje, dhe është duke pritur hulumtim të kontestit nga KEK-u ose organet e tjera përgjegjëse.

6.2. Në rast të kontestimeve të tilla, KEK-u ose autoritetet e tjera përgjegjëse duhet të hulumtojnë kontestin dhe ti komentojnë konsumatorit vendimin e tij brenda periudhës më të shkurtër kohore që është e mundur

6.3. Varësisht nga rrethanat, konsumatorit mund t'i kërkohej që të shpjegoj arsyet për aktin e supozuar ose lënjën anash dhe ofrimin e ndonjë dokumenti përkatës.

6.4. Nëse është e kontestueshme fatura, KEK-u nuk do të shkyç konsumatorin duke u bazuar në mos-pagesën e shumës së plotë të faturës përveç dhe derisa KEK-u të ketë shqyrtuar dhe të ketë përcaktuar në lidhje me saktësinë e faturës. Deri sa të jetë bërë një shqyrtim i tillë, konsumatorit duhet t'i kërkohej të bëjë pagesën:

- a) për pjesën e faturës që është e pakontestueshme; ose
- b) mesataren e faturave të pakontestuara të paguara nga konsumatori gjatë gjashtë (6) muajve të mëparshëm, kur fatura të jetë lëshuar nën kontratën komerciale që ka qenë në forcë dymbëdhjetë (12) muaj ose më shumë; ose
- c) mesataren e të gjitha faturave të pakontestuara të paguara nga konsumatori gjatë tre (3) muajve të mëparshëm, kur është lëshuar fatura nën kontratën komerciale që ka qenë në forcë më pakë se dymbëdhjetë (12) muaj.

6.5. Pamvarësisht nga kjo marrëveshje, KEK-u do të shkyçë një konsumator që dështon të paguaj shumën e specifikuar në pikën 6.4.

7. Çasja në pronë

Në rast se KEK-ut i ndalohet që të ketë fizikisht qasje në pronën ku do të bëhet shkyçja, KEK-u do të dërgojë një raport për incidentin tek zyrtarët lokal që zbatojnë ligjin.

8. Gjuha e Njoftimit dhe komunikimet e tjera me shkrim me konsumatorët

Përveq nëse nuk hiqet dorë me një marrëveshje specifike me shkrim, sipas kontratës së konsumatorit, të gjitha shkyçjet dhe njoftimet paralajmëruese dhe komunikimet e tjera me konsumatorët në lidhje me shërbimin e ndërmarrjes së energjisë duhet të jenë të shkruara në gjuhën Shqipe, Serbishte dhe Anglishte qartas, konciz, dhe në mënyrë që kuptohet lehtë.

9. Kyçjet dhe rikyçjet e paligjshme

9.1. Një konsumator që kyçë ose rikyçë shërbimet e energjisë pa autorizim me shkrim nga KEK-u do t'i paguaj KEK-ut dënim të njëjtë me shumën e përcaktuar në përputhje me Kapitullin 2 të këtij vendimi.

9.2. Një dënim i tillë do t'i shtohet shumës që duhet të paguhet për energjinë e konsumuar gjatë kyçjes ose shkyçjes së paautorizuar.

9.3. Nëse një konsumator bënë rikyçje të paautorizuar, KEK-u mund të dërgoj një raport të veprimit të konsumatorit tek zyrtarët lokal që zbatojnë ligjin. KEK-u pastaj mund të heqë të gjitha paisjet dhe pjesët, duke përfshirë linjat e distribuimit/gypat, paisjet matëse dhe paisjet e tjera ndihmëse të nevojshme për themelimin e kyçjes në pronat e konsumatorëve dhe që janë përdorur për të mundësuar ose lehtësuar një kyçje të paautorizuar.

9.4. Konsumatori që është kyçur ose rikyçur në mënyrë të paligjshme do të jetë përgjegjës që të paguaj gjobën ashtu siç është paraparë në Kapitullin 2, dhe mund të ngarkohet për:

a) shpenzimet e përtërirjes së kyçjes së pronës me shërbim. Shpenzimet e tilla nuk do të jenë më të larta se shpenzimet e themelimit të kyçjes së një konsumatori të ri, dhe

b) shpenzimet e energjisë që ndërmarrja e energjisë vlerëson që i janë ofruar pronës, përveq nëse konsumatori mund të ofroj evidencë të kënaqëshme që ai ose ajo nuk e ka zotëruar objektin gjatë kohës së konsumit të pretenduar. Në një rast të tillë konsumatori mund të jetë i detyruar vetëm për periudhën gjatë së cilës ai/ajo ka zotëruar objektin.

10. Rikycja nga ndërmarrja e energjisë

10.1. KEK-u do të rikyçë pronën e konsumatorit jo më vonë se dy (2) ditë pune pasi: të jetë rivendosur arsyeja për shkyçje, përfshirë atëherë kur konsumatori të ketë paguar shumën e plotë të faturës së tij, të ketë nënshkruar marrëveshjen për pagesë me KEK-un, ose të ketë përbushur veprimin e kërkuar që ka qenë arsye e shkyçjes.

10.2. Në rast të përsëritjes së veprimit që rezulton me shkyçje ose mospagesë të përsëritur të faturës, KEK-u mund të refuzoj që të rikyç këtë konsumator. Në një rast të tillë, KEK-ut i lejohet që të heqë paisjet e konsumatorit për furnizim me energji

10.3. Në rast të përsëritjes së shkeljes së njëjtë, gjoba e vendosur mund të jetë dy herë më e madhe se shuma e autorizuar në skemën e Gjobave dhe Dënimeve.

10.4. Ç’do herë që shkelja përsëritet KEK-u mund të vë gjobë ashtu siç është paraparë në Nenin 10.3 të këtij vendimi.

10.5. Rikycja duhet t’i nënshtrohet ngarkesave të tilla ashtu siç është paraparë në Kapitullin 2, dhe në Nenin 10.2 përveç kur shkyçja është bërë për arsye operative/mirëmbajtje/rrezik dhe/ose arsye të tjera teknike të rrjetit.

Kapitulli 2: Skema e Pagesave dhe Dënimeve

A. Përgaditja dhe dërgimi i njoftimit për shkyçje	10 – euro																																													
B. Shkyçje (Amvisëri) dhe rikyçje (Amvisëri)	50 – euro																																													
C. Shkyçje (jo-Amvisëri) dhe rikyçje (jo-Amvisëri)	100 – euro																																													
D. Shkyçje dhe rikyçje për përdorim të paautorizuar, ngacim të matësit dhe Vjedhje	1000- euro																																													
Rikyçje ilegale të ndërtesës pasi të jetë shkyçur nga KEK-u (Amvisëri dhe Jo-Amvisëri)	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Grupi Tarifor</th> <th>Përshkrimi</th> <th>Shuma</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1/1</td> <td>110 KV-2</td> <td>2.000 -euro</td> </tr> <tr> <td>1/2</td> <td>35 KV –2</td> <td>2.000 -euro</td> </tr> <tr> <td>1/3</td> <td>10 KV –3</td> <td>2.000 -euro</td> </tr> <tr> <td>4/01</td> <td>0.4 KV HH Një TM-4</td> <td>100 -euro</td> </tr> <tr> <td>4/02</td> <td>0.4 KV HH Dy TM-4</td> <td>100-euro</td> </tr> <tr> <td>5/41</td> <td>Parapaguar HH</td> <td>100-euro</td> </tr> <tr> <td>5/71</td> <td>Parapaguar Komercial</td> <td>300 -euro</td> </tr> <tr> <td>6/6</td> <td>0.4 KV Cat. 1-6</td> <td>300 -euro</td> </tr> <tr> <td>7/01</td> <td>0.4 KV Cat.2 Një TM-7</td> <td>300 -euro</td> </tr> <tr> <td>7/02</td> <td>0.4 KV Cat.2 Dy TM-7</td> <td>300 -euro</td> </tr> <tr> <td>8/01</td> <td>Ndriqimi Publik-8</td> <td>300 -euro</td> </tr> <tr> <td>9/1</td> <td>Vlera Fikse < 400 kWh</td> <td>100-euro</td> </tr> <tr> <td>9/2</td> <td>Vlera Fikse 400-800 kWh</td> <td>100-euro</td> </tr> <tr> <td>9/3</td> <td>Vlera Fikse > 800 kWh</td> <td>100-euro</td> </tr> </tbody> </table>	Grupi Tarifor	Përshkrimi	Shuma	1/1	110 KV-2	2.000 -euro	1/2	35 KV –2	2.000 -euro	1/3	10 KV –3	2.000 -euro	4/01	0.4 KV HH Një TM-4	100 -euro	4/02	0.4 KV HH Dy TM-4	100-euro	5/41	Parapaguar HH	100-euro	5/71	Parapaguar Komercial	300 -euro	6/6	0.4 KV Cat. 1-6	300 -euro	7/01	0.4 KV Cat.2 Një TM-7	300 -euro	7/02	0.4 KV Cat.2 Dy TM-7	300 -euro	8/01	Ndriqimi Publik-8	300 -euro	9/1	Vlera Fikse < 400 kWh	100-euro	9/2	Vlera Fikse 400-800 kWh	100-euro	9/3	Vlera Fikse > 800 kWh	100-euro
Grupi Tarifor	Përshkrimi	Shuma																																												
1/1	110 KV-2	2.000 -euro																																												
1/2	35 KV –2	2.000 -euro																																												
1/3	10 KV –3	2.000 -euro																																												
4/01	0.4 KV HH Një TM-4	100 -euro																																												
4/02	0.4 KV HH Dy TM-4	100-euro																																												
5/41	Parapaguar HH	100-euro																																												
5/71	Parapaguar Komercial	300 -euro																																												
6/6	0.4 KV Cat. 1-6	300 -euro																																												
7/01	0.4 KV Cat.2 Një TM-7	300 -euro																																												
7/02	0.4 KV Cat.2 Dy TM-7	300 -euro																																												
8/01	Ndriqimi Publik-8	300 -euro																																												
9/1	Vlera Fikse < 400 kWh	100-euro																																												
9/2	Vlera Fikse 400-800 kWh	100-euro																																												
9/3	Vlera Fikse > 800 kWh	100-euro																																												
D. Gjobat për ndërmarrjet e energjisë jo-të përputhura me dispozitat e këtij Vendimi	2000 euro për ndërmarrjet e energjisë për një rast; 1/3 nga paga e përsosnit të autorizuar																																													

11. Aplikueshmëria

11.1. Ky vendim është i aplikueshëm për të gjithë konsumatorët në Kosovë që përdorin shërbimet e energjisë elektrike të ofruara nga KEK-u.

11.2. Ky vendim do të publikohet nga KEK-u, së paku në një nga gazetatat ditore që qarkullojnë në tërë Kosovën, pesë (5) ditë të punës pas afatit të fundit që është vendosur në pikën 11.5 të këtij Vendimi.

11.3. KEK-u ka të drejtë që të ankohet në ZRrE-në duke dorëzuar një raport të plotë substancial, brenda (14) ditëve të punës pasi të jetë shpalluar dhe të jetë publikuar ky vendim Zyrtar në website-in e ZRrE-së.

11.4. KEK-u do të filloj të implementoj dispozitat e këtij vendimi brenda 60 ditëve që nga data e këtij publikimi nga ZRrE-ja.

11.5. Vendimi do të zëvendësohet nga Rregulla për shkyçje e lëshuar nga Bordi i ZRrE-së ashtu siç është përcaktuar në Nenin 58 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Në emër të ZRrE-së

Dr. Nick F Frydas
Kryesues i Bordit